



V E N D I M
Nr. 73, datë 30.11.2017

PËR
MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO-LIGJOR DHE VLERËN E
DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA ZJARRI

Mbështetur në nenet 54 shkronja “dh”, 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.8756, datë 26.03.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore“, udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKB nr. 8, datë 30.01.2017 “Për buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2017”, VKB nr. 15, datë 1.3.2017, VKB nr. 22, datë 30.3.2017, Shkresa nr. 3950 prot, datë 21.06.2017 e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 30.11.2017, pas diskutimeve,

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Këshilli i Qarkut Shkodër për vlersimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri për familjet e z. Bujar Muka, z. Halit Shpuza dhe z. Mehmet Shpuza.
2. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 1,706,559.30 lekë (*një milion e shtatëqind e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë tridhjetë*), dhe orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 364,080 lekë (*treqind e gjashtëdhjetë e katërmijë e tetëdhjetë*), sipas preventivava, për familjen e z.**Bujar Muka**, në total vlera në shumën 2,070,639.30 lekë (*dy milion e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë pikë tridhjetë*).

3. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 746,156.90 lekë *(shtatëqind e dyzet e gjashtë mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë nëntëdhjetë)*, sipas preventivava, për familjen e z.**Halit Shpuza**.
4. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore 949,088.70 lekë *(nëntëqind e dyzet e nëntë mijë e tetëdhjetë e tetë pikë shtatëdhjetë)*, sipas preventivava, për familjen e z. **Mehmet Shpuza**.
5. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Punëve të Brendshme për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për familjet e z. Bujar Muka, z. Halit Shpuza dhe z. Mehmet Shpuza, sipas përcaktimeve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012, për shkak të pamundësisë së bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari e Bashkisë.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.11.2017


Shpallur në datën 1.12.2017

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI QARKU SHKODËR

Spektori Juridik & Spektori i Perballimit te Emergjencave & Krizave

1.18838 18.12.2017

Nr1235/1Prot

Shkoder me 15.12.2017

Lënda: Mbi vendimin nr.73 datë 30.11.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Shkodër

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale te ligjit Nr.107/2016 dt 27.10.2016 "Për Prefektin", në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për veteqeverisjen vendore", neni 29, neni neni 64 germa c, ligjit Nr.8756,dt. 26.03.2001 "Per emergjencat civile", i ndryshuar, VKM NR.329 dt 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënjes së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhezimit të Ministrave të Financave dhe të Ministrise se Brendshem Nr.263 datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmes shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore", VKM Nr.629 dt.15.07.2015 "Per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre", VKB Nr.8 dt 30.01.2017 "Mbi miratimin e buxhetit te bashkise Shkoder 2017", VKB Shkoder Nr.15 dt 1.03.2017 "Mbi dhënien e ndihmës financiare, marre nga fondi i Drejtorise së Emergjencave Civile dhe MZSH-se ne matrikullen P13,F102A1 për familjet që kanë pësuar dëme nga zjarri", VKB Shkodër Nr.22 dt.30.03.2017 "Mbi dhënien e ndihmes financiare te menjehershme marre nga fondi i Drejtorise se Emergjencave Civile dhe MZSH-se ne matrikullen P13,F1 02A1 per familjet qe kane pesuar dëme te shkaktuara nga zjarri dhe reshjet e deborës dhe ngricat", vkb Shkoder nr.15 dt.1.03.2017, vkb Shkoder nr.22 dt.30.03.2017, Shqyrtoi vendimin Nr.73 datë 30.11.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër: "Mbi miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe vleren e dëmeve te shkaktuara nga zjarri per familjen e Z.Bujar Muka ne vlere totale 2.070.639.30 leke djegur me dt.18.01.2017 Z.Halit Shpuza ne vlere totale 746.156.90 leke dhe Z.Mehmet Shpuza ne vlere totale 949.088.70 leke djegur me 31.01.2017 banorë te Bashkise Shkodër".

Pas shqyrtimit konstatohet:

- Tek preventivat ndërtimor te tre familjeve te Z.Bujar Muka, Z.Halit dhe Z.Mehmet Shpuza te Zeri prishje suvatime mure te brendshme është përcaktuar çmimi 169 lekë dhe jo 146 lekë (vlere e saktë për të cilën ju duhet të procedoni).
- Lidhur me vlerësimin e orendive dhe paisjeve elektro-shtëpiake çdo artikull duhet të jete i specifikuar sipas listës te çmimeve.
- Sipas Sektorit të përballimit të krizave dhe emergjencave civile është konstatuar se te preventivat përkatës te te dëmtuarve nuk jane vendosur datat e përpilimit të akteve për efekt të verifikimit te praktikave lidhur me afatet perkatese, referuar VKM Nr.329 dt.16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënjes së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".

Përsa më sipër, Prefekti ju autorizon të duke konsideruar prioritet familjet e dëmtuara të cilat nuk mund të penalizohen nga pasaktësitë e stafit administrativ, me kusht që të bëhen të gjitha saktësimet sipas akteve ligjore në fuqi.

Me respekt,

PREFEKTI

ÇESK MILLJA

